Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/ AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV
INFORMATIVNI BILTEN
INFORMATION NEWSLETTER
#2013

Prishtinë, 2013

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/ AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV
2013

Mandati i Agjencisë për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit

Qeveria e Kosovës me vendim nr.5/131 të, datës 1 shkurt 2005 ka themeluar Zyrën për Barazi gjinore si organ te veçant të Qeverisë së Kosovës, konform nenit 5.1 Rregullorës së UNMIK-ut, Nr. 2004/18, të datës 7 qershor 2004, mbi shpalljen e Ligjit për Barazi Gjinore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr. 2004/7). Me vendimin e Qeversië së Kosovës nr. 03/2006 të datës 12.07.06 Zyra për Barazi Gjinore prej 1 Shtatorit 2006 shëndrrohet në Agjenci për Barazi Gjinore, në Zyren e Kryeministrit. Agjencia për Barazi Gjinore është organ i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandat të hartojë, të zbatoj, të propozoj, të koordinojë dhe të monitorojë politikat vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në Kosovë.

Ky vëllim është përgatitur nga :

Agjencia për Barazi Gjinore – Zyra e Kryeministrit,
Republika e Kosovës

Janar 2014

Të drejtat e botimit i takojnë

Agjencisë për Barazi Gjinore- Zyra e Kryeministrit,
Republika e Kosovës

http://abgj.rks-gov.net/

Adresa:
Agjencia për Barazi Gjinore
Zyra e Kryeministrit
Sheshi Nëna Tereza
Kati VII, Prishtine, 10000
Tel: +381 38 200 14280
E-mail: info.abgj@ks-gov.net

Përmbajtja

- Editorial: Edona Hajrullahu, Kryeshefe Ekzekutive, ABGJ/ZKM 7

Iniciativat e Agjencisë për Barazi Gjinore

- Miratohen Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.....8
- Prezantimi i hulumtimit "Gratë në mediat e shkruara" për periudhën 2010-2011.....9
- Masë afirmative për gratë dhe vajzat në shërbimin civil të Republikës së Kosovës 10

Aktivitetet Avokuese

- Konferenca rajonale "Qasja e grave në pronë" 11
- Tryeza e Diskutimit "Qasja në drejtësi për gratë dhe vajzat, viktima të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë" 12
- Procesi i Planifikimit Hapësinor dhe Perspektiva Gjinore –Sfidat dhe Praktikat 13
- 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas -16 Ditët e Aktivizmit.....14
- Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore 16

Bashkëpunimi me Institucionet relevante

- Takimi i Grupit Punues Sektorial për Koordinimin e Donatorëve në Qeverisje, me fokus në Barazinë Gjinore.....19
- Vizita në Institutin Evropian për Barazi Gjinore, Vilnius të Lituanisë 19
- Pjesëmarrja në Konferencën Konventa e tretë e Stambollit Mbi Promovimin e të Drejtave të Grave 20
- Pjesëmarrje në Konferencën "Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Prostitucioni", Kroaci 20

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna 21

Editorial: Edona Hajrullahu, Kryeshefe Ekzekutive, ABGJ/ZKM

Nuk mund të kemi barazi gjinore të mirëfilltë pa realizimin e të drejtës në pronë Barazia gjinore është një e drejtë themelore në çdo shoqëri demokratike. Gjithsesi, edhe pse kjo çështje është në qendër të agjendës së institucioneve, faza në të cilën ndodhemi kërkon një angazhim edhe më serioz në promovimin dhe zbatimin e politikave që garantojnë pjesëmarrje të balancuar gjinore në gjitha nivelet shoqërore .

Në këtë kuadër, edhe qasja e grave në pronë është një faktor i rëndësishëm, i cili është i lidhur drejtpërdrejtë me fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave, e që njëkohësisht ndikon në eliminimin e deformimeve sociale, siç janë diskriminimi dhe dhuna në baza gjinore. E drejta në pronë, është një e drejtë themelore që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit, si dhe nëpërmjet ligjeve në fuqi si Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Familjen, Ligji i Trashëgimisë, Ligji mbi Pronën dhe Ligji kundër Diskriminimit.

Ligji mbi Trashëgiminë përcakton në mënyrë të qartë që sikur djemtë ashtu edhe vajzat, janë të barabartë, dhe si të tillë kanë edhe të drejta të barabarta në përfitimin e trashëgimisë familjare. Thënë kjo, qasja në të drejtat e pronësisë dhe zotërimi i pronës, janë dy nga shumë tregues të tjerë shoqëror, të cilët janë barometër të progresit dhe barazisë gjinore në vend. Edhe pse legjislacioni ynë garanton të drejta të barabarta për burrat dhe gratë, pesha e traditës, mentalitetit, gjendja e dobët ekonomike, si dhe niveli i ulët i arsimimit, flasin kundër një barazie reale, një pabarazi e cila është edhe më e theksuar në zonat rurale të Kosovës.

Prandaj, duke garantuar një qasje të barabartë ndaj pronës dhe shfrytëzimit të saj, ne nxisim barazinë mes dy gjinive, dhe rrjedhimisht ndikojmë në një zhvillim ekonomik më të hovshëm të vendit, pasi vetëm në këtë rrugë do shfrytëzohej potenciali i gjysmës së popullsisë, të cilën e përbën gjinia femërore. Në anën tjetër, përveç ndikimit pozitiv në zhvillimin ekonomik, prona është mjeti thelbësor për eliminimin e pasigurisë, si dhe akteve primitive siç është edhe dhuna mbi baza gjinore. Duke u nisur nga kjo, Agjencia për Barazi Gjinore është e angazhuar maksimalisht që të hartojë politika me qëllim të fuqizimit të pozitës së femrës në Kosovë.

Gjatë vitit 2013, Agjencia për Barazi Gjinore ka filluar hulumtimin "Qasja e grave në pronë", i cili do merret me rishikimin e të gjithë infrastrukturës ligjore mbi pronën, dhe njëkohësisht do të analizojë praktikat dhe vlerat tona shoqërore. Në këtë mënyrë ne synojmë të ngushtojmë boshllëqet apo diskrepancat që ekzistojnë mes ligjeve në fuqi dhe praktikave nga jeta e përditshme. Kosova si një shtet i ri, dhe qytetarët e saj, kanë mundësinë të dëshmojnë që historinë e shtetit tonë po e shkruajnë mbi bazën e vlerave dhe parimeve të barazisë mes dy gjinive, ku burrat i trajtojnë gratë si partnere ekuivalente, e ku traditat patriarkale sfidohen dhe zëvendësohen me praktika bashkëkohore.

Me përkushtimin e institucioneve dhe vullnetin e qytetarëve, ne mund të ndërtojmë një shoqëri të shëndoshë, ku mbizotëron harmonia, dhe respekti i vlerave njerëzore. Prandaj, jam e prirur të besoj që edukata familjare si dhe arsimimi i vajzave luajnë një rol të pazëvendësueshëm në formimin e tyre. Prindërit duhet t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë fëmijët, pavarësisht se cilës gjini i përkasin, por në anën tjetër edhe vetë vajzat duhet të jenë më kërkuese dhe t'i përkushtohen më shumë avancimit të tyre akademik, me qëllim të fuqizimit të rolit të tyre në shoqërinë tonë. Vetëm në këtë mënyrë, ndryshimet do jenë pozitive dhe përfundimisht të qëndrueshme.

Miratohen Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje

Bazuar në Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, konform Objektivit Strategjik2 (Hartimi i Procedurave Standarde operative për trajtimin e viktimave të dhunës në familje), Agjencia për Barazi Gjinore ka hartuar dhe publikuar: Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, përmes të cilave ndërtohet një sistem i koordinuar i institucioneve për të reaguar në formë të menjëhershme në rastet e dhunës në familje, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave.

Me rastin e publikimit, ABGJ ka organizuar takim me institucionet relevante të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të informohen me obligimet e tyre qe rrjedhin nga këto procedura, si dhe të koordinojnë referimin e viktimave në shërbimet ekzistuese.

Kryeshefja ekzekutive e ABGJ-së, Edona Hajrullahu theksoi se hartimi i këtyre procedurave përbën një prej hallkave më të rëndësishme në të gjithë infrastrukturën ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje.

"Pa dyshim infrastruktura ligjore e deritanishme dhe ky dokument përbëjnë hapa shumë të rëndësishëm për vendin tonë, por ne duhet të marrim edhe hapa praktik, në mënyrë që secili institucion që merr obligime në këtë sfidë të kryejë me përkushtim dhe përgjegjësi detyrat që i ka. Një bashkërendim dhe veprim i të gjithëve do të sjellë pashmangshëm rezultate pozitive në këtë aspekt".

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka kontribuar dhe ka ofruar ekspertizë profesionale në kuadër të grupit të punës për hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Po ashtu, ky dokument është një udhëzues pune i vlefshëm dhe i qartë për të drejtuar veprimet e tyre me efektivitet të plotë në përmbushjen e detyrave, duke iu treguar në mënyrë kronologjike se cila strukturë përfshihet në cilën etapë.

Pra, të gjitha institucionet e mandatuara për luftimin e dhunës në familje, duhet të koordinohen sa më mirë dhe të jenë më efikase në përgjigjen e tyre, ndaj këtij fenomeni negativ.

Në kuadër të promovimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Agjencia për Barazi Gjinore e ka realizuar edhe një videoklip, me mesazh të qartë që nëpërmjet zbatimit të këtij dokumenti të parandalohet dhuna në familje, si dhe të mbrohen dhe trajtohen viktima e dhunës ne familje.



▪ *Sekuenca nga videoklipi i realizuar për lansimin e PSV-ve*

Prezantimi i hulumtimit "Gratë në mediat e shkruara" për periudhën 2010-2011

Në përputhje me objektivat strategjik të paraparë në PKBGJ, Agjencia për Barazi Gjinore gjatë vitit 2013 ka realizuar edhe hulumtimin "Gratë në mediat e shkruara" për periudhën 2010-2011. Ky hulumtim për objekt të analizës ka pasur mënyrën sesi janë paraqitur dhe trajtuar në media femrat dhe problemet e përkatësisë gjinore.

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të institucioneve të Kosovës dhe shoqërisë civile në përgjithësi, për përmirësimin e pozitës së gruas dhe arritjen e barazisë gjinore, realiteti është larg asaj çfarë gruaja meriton.

Madje, pavarësisht përparimeve në ngritjen e gruas, sot jo vetëm në Kosovë, por edhe në shumë vende tjera të botës, ende vihet re një hendek mes kapacitetit dhe nevojave të tyre dhe burimeve që ato disponojnë si në aspektin e arsimimit, punësimit, përfshirjes në vendimmarrje, etj.

Kështu, ky hulumtim i realizuar nga ABGJ bazuar në objektivat e parapara në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) dhe Planin e Veprimit 2011-2014, si dhe Ligjin për Barazi Gjinore, është shkruar për të kuptuar rolin e medias në integrimin gjinor.

Respektivisht hulumtimi kishte si qëllim të ofrojë një pasqyrë se si i trajtuan mediat e shkruara, gjatë periudhës 2010-2011, gruan dhe çështjet gjinore. Sfida qëndron në faktin se si prezantohen ngjarjet, titujt nëpër gazeta, çfarë ato pasqyrojnë dhe mënyra e analizimit të fenomeneve.

Gazetat të cilat janë monitoruar gjatë hulumtimit kanë qenë: Kosova Sot, Bota e Re, Koha Ditore, Gazeta Express, Tribuna Shqiptare, Epoka e Re dhe Info Press.

Rekomandimet e dala nga hulumtimi:

- *Për shkak të ndikimit shumë të madh që kanë mediat e shkruara, duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të pasur monitorim të rregullt të mediave dhe hapësirës që iu kushtohet grave, dhe në përgjithësi kontributit që ato japin në fushën e barazisë gjinore.*
- *Duhet të ofrohen trajnime të specializuara për gazetarë në fushën e raportimit mbi çështjet e ndjeshme, si: trafikimi mbi qenie njerëzore, dhuna në familje, si pjesë e programeve trajnuese të qëndrueshme.*
- *Mediat duhet që përmes shkrimeve të tyre, të ndikojnë në ndërtimin e vlerave dhe qëndrimeve pozitive për barazi gjinore dhe në këtë mënyrë të rrisin vetëdijen e opinionit publik për rëndësinë dhe përfitimet e shoqërisë nga barazia gjinore.*
- *Mediat e shkruara në Kosovë duhet të kenë kujdes të veçantë kur raportojnë për fenomene të ndryshme që preokupojnë gratë, duke mos cenuar privatësinë e tyre.*
- *Mediat duhet të luajnë rolin e vet, jo vetëm në informimin e publikut, por edhe në hapësirën e ofruar për gratë, për promovimin e të arriturave dhe sukseseve, me theks të veçantë tek gratë dhe vajzat nga zonat rurale.*
- *Mediat duhet t'u ofrojnë hapësirën me të madhe shkrimeve që ndikojnë në ngritjen e vetëdijes tek femrat e reja për dukuritë negative, me qëllim të parandalimit.*

Masë afirmative për gratë dhe vajzat në shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Duke u nisur nga objektivat e parapara në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, Agjencia për Barazi Gjinore me qëllim të ngritjes së numrit të grave dhe vajzave në pozita vendimmarrëse edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar iniciativën për financimin e studimeve Master për Zyrtaret e Shërbimit Civil, që të vazhdojnë shkollimin pa shkëputje nga puna. Në këtë mënyrë, atyre u është lehtësuar avancimi në karrierë.

Për vitin akademik 2013/14 ka arritur të përzgjidhet një zyrtare, e cila i ka plotësuar kriteret e parapara në konkurs dhe tashmë është realizuar faza e parë e financimit.

Konferenca rajonale "Qasja e grave në pronë"

Nisur nga parimet e Ligjit për Barazi Gjinore, në bazë të së secilit sigurohet që femrat dhe meshkujt të gëzojnë të drejtën në pronësi, respektivisht në regjistrim të pronës dhe trashëgimi të pronës në mënyrë të barabartë, Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, kanë organizuar konferencën rajonale me temë: "Qasja e grave në pronë". Në konferencë morën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia, për të ndarë eksperiencat më të mira në fushën e pronës dhe çështjeve gjinore.

Të dhënat tregojnë se gratë në Kosovë, në shumicën e rasteve, nuk e gëzojnë të drejtën e trashëgimisë familjare, pasi pasuria e familjes, rregullohet sipas zakoneve, dhe ndahet në mënyrë të barabartë vetëm mes meshkujve të familjes. Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës vetëm 15 përqind e pronave janë të regjistruara në emër të gjinisë femërore. Madje, mbetet shqetësuese se në shumicën e familjeve shqiptare në Kosovë, veçanërisht në zonat rurale, femra respektivisht motra, nuk trashëgon pronë as kur vdes babai edhe nëse nuk ka vëlla.

Gjatë konferencës është konstatuar se ende ka punë për t'u bërë në përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe sigurimin e pavarësisë ekonomike. Sistemi i deklarimit të së drejtës për patundshmëri private, duke përfshirë pronat bujqësore apo komerciale duhet të jetë i mundur për të gjithë personat fizik, pa marr parasysh gjininë, racën, përkatësinë etnike, etj.

Kushtetuta e Kosovës ka kornizë të konsoliduar ligjore e cila garanton dhe mbron të drejtat e gruas, dhe gërsheton principet e përgjithshme të barazisë dhe mos-diskriminimit. Që kjo të zbatohet me efikasitet, Agjencia për Barazi Gjinore ka planifikuar që këtë vit ta trajtojë me më shumë kujdes këtë çështje, duke nxjerr një udhëzim ose masë afirmative të përkohshme, e cila do të mund të stimulonte edhe bashkëshorten që të regjistronte pronën në emrin e saj, do të thotë në emër të përbashkët.



Ndërkaq, Agjencia për Barazi Gjinore ka filluar edhe me një hulumtim në nivel vendi e cila ka për temë: "Qasjen e grave në pronë dhe burime natyrore", me anë të së cilit hulumtim presim të dalim me rekomandime të qarta se si të adresohet më konkretisht ky fenomen, që ende po vazhdon të jetë tabu për familjet shqiptare.

Rekomandimet e dala nga Konferenca Rajonale "Qasja e grave në pronë":

- *Institucionet, organizatat, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe partnerët të vazhdojnë punën dhe të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me qasjen e barabartë në pronë, si për meshkuj ashtu për femra;*
- *Të vazhdojë bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore përmes organizimit të fushatave vetëdijësuese, duke potencuar rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe inkurajimin e grave që të kërkojnë të drejtat e tyre të garantuara me Ligjin, mbi të drejtën e trashëgimisë.*
- *Zyra për regjistrim të pronës së paluajtshme, Zyra Kadastrale duhet të regjistrojë të gjithë bashkëpronarët e pronave, veçanërisht bashkëshortëve;*
- *Përmirësimi i pozitës ekonomike të gruas influencon ndryshim në rolet gjinore.*
- *Që të përmirësohet efikasiteti dhe qëndrueshmëria e politikave dhe ngritja e përgjegjësisë për nevojat e grave është e domosdoshme të përfshihen në thellësi analizat gjinore në politika, përfshirë analizat për buxhetimin gjinor për zhvillimin e programeve dhe masave afirmative për ngritjen dhe pjesëmarrjen e grave në programe të tilla.*
- *Gratë nuk duhet të dorëzohen para sfidave dhe të pranojnë rolin e viktimës, por duhet të vetëdijesohen që të kërkojnë të drejtat e tyre legjitime sa i përket trashëgimisë, dhe në këtë çështje përveç gjyqësorit duhet të merren edhe strukturat e tjera qeveritare dhe jo qeveritare, për të vetëdijesuar gratë për të realizuar të drejtat e veta pronësore trashëgimore.*
- *Marrja e masave afirmative, iniciativave stimuluese për të rritur qasjen e grave në biznes.*
- *Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve garantohet me ligj dhe rekomandohet që ligji të adresojë saktësisht organin ekzekutues të dënimit, në rast të mos zbatimit të ligjit.*
- *Masa afirmative rekomandohet që sistemi bankar të ulë interesin për kredi, për gratë që dëshirojnë të iniciojnë biznes.*
- *Qytetaret duhet të informohen për përfitimet që i gëzojnë nëse e regjistrojnë pronën në emrin e tyre.*

Konferencë me temë "Qasja e grave në pronë", u organizua në përmbyllje të Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimi e Dhunës ndaj Gruas (25 nëntor- 10 dhjetor).

Konferenca u mbështetet nga misioni i OSBE-së në Kosovë, Banka Botërore dhe GIZ-LMK.

Tryeza e Diskutimit

"Qasja në drejtësi për gratë dhe vajzat, viktima të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë"

Agjencia për Barazi Gjinore për Ditën Ndërkombëtare të Gruas – 8 Marsi, ka organizuar një tryezë diskutimi, me temë "Qasja në drejtësi për gratë dhe vajzat, viktima të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë", sepse që nga paslufta, gjendja e këtyre grave jo vetëm në aspektin material, por edhe në atë social, shëndetësor e juridik, e mbi të gjitha në atë shpirtërorë ka qenë e mjerueshme.

Tryeza në fjalë kishte për synim të mbledhë së bashku të gjithë akterët që ofrojnë mbështetje për gratë dhe vajzat, viktima të dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë. Madje të pranishmit e tryezës theksuan nevojën për shqyrtimin e opsioneve dhe nxjerrjen e rekomandimeve konkrete, se si të orientohen politikat shtetërore drejt një zgjidhjeje që përfaqëson më së miri interesat e këtyre viktimave.

Tani mbetet të hartohet një platformë institucionale, e cila do të kishte identifikuar këto grupe të ndjeshme shoqërore dhe do t'u kishte njohur të drejtën e dëmshpërblimit dhe shërbimeve adekuate sipas problemeve që kanë përjetuar viktimat si pasojë e dhunës.

Ky aktivitet është bazuar në objektivat e Planin e Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria", me zbatimin e këtij plan veprimi nacional, Viktimat e dhunës seksuale, torturës dhe formave të tjera të dhunës së luftës të kenë qasje në mekanizma funksional për mbrojtjen, qasjen në drejtësi, rehabilitimin dhe re-integrimin e tyre.

Rekomandimet e dala nga Tryeza e Diskutimit:

- *Qeveria ka vullnetin t'i përkrah këto kategori të grave në mënyrë institucionale përmes amandamentimit të ligjit për kategoritë e dala nga lufta siç u deklaruan edhe organizatat joqeveritare të cilat shprehen rekomandimet e këtyre grave.*
- *E gjithë shoqëria duhet të angazhohet në destigmatizimin e kësaj kategorie të grave dhe qe t'ua ofrojmë përkrahjen gjithëmbarshëm nëpërmes angazhimit të institucioneve, shoqërisë civile si dhe krerëve fetar.*
- *Rekomandimi i përgjithshme është që këto gra kanë nevojë për përkrahje institucionale të qëndrueshme, përmes formave të trajnimit profesional, formimit profesional dhe angazhimit në punë me ç'rast do të zgjidhej statusi i tyre ekonomik i qëndrueshëm.*

Procesi i Planifikimit Hapësinor dhe Perspektiva Gjinore – Sfidat dhe Praktikat

Në kuadër të angazhimeve për krijimin e një ambienti sa më të mirë në aspektin e perspektivës gjinore, Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me UNHABITAT, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Asociacionin e Komunave të Kosovës, ka mbajtur tryezën me temë: "Procesi i Planifikimit dhe Perspektiva Gjinore – Sfidat dhe Praktikat".

Tryeza në fjalë si qëllim parësor kishte prezantimin e praktikave të ndryshme në procesin e planifikimit dhe perspektivën gjinore në këtë proces, si dhe të adresojë dhe të analizojë sfidat në dy nivele të pushtetit, atë qendror dhe lokal.

Kryeshefja ekzekutive e ABGJ-së, Edona Hajrullahu vuri në dukje politikat që janë hartuar dhe hapat që po ndërmerren nga institucionet kompetente për të adresuar çështjet e ndjeshme gjinore.

Sipas saj, krahas një planifikimi të mirë të proceseve zhvillimore, kërkohet të bëhet edhe adresim i nevojave të ndryshme të të gjithë anëtarëve të një komuniteti në mënyrën më të drejtë të mundur.

Ndërkaq gjatë tryezës, përveç ABGJ-së e cila bëri një prezantim lidhur me çështjet gjinore, kërkesat ligjore dhe mekanizmat ligjor ekzistuese, lidhur me sfidat dhe praktikat në procesin e planifikimit me shembuj konkret u paraqiten përfaqësues të komunës së Ferizajt, Junikut, Graçanicës, Mamushës, si dhe nga Zyra për Barazi Gjinore pranë Universitetit të Prishtinës.

Kështu, duke kuptuar dimensionet gjinore në shoqëri do të dalin në pah nevojat e ndryshme dhe pikëpamjet e burrave e grave në drejtim të mjediseve në të cilat ata jetojnë.

Më praktikisht, Procesi i Planifikimit dhe Perspektiva Gjinore – Sfidat dhe Praktikat nënkuptojnë standarde të parapara që u garantojnë grave dhe vajzave: siguri - lëvizje të lirë - rrugë, hapësira të ndriçuara dhe të sigurta; hapësira adekuate që u përgjigjen nënave me fëmijë të vegjël, hapësira dhe ambiente të sigurta në kuptimin arkitektonik -hapësinorë që sigurojnë mirëqenie dhe prosperitet. Me fjalë të tjera, lokacioni i vendosjes së çerdheve/kopshteve publike, shkollave, shtëpive të shëndetit, qendrave kulturore dhe rekreative, linjave të transportit konform nevojave të grave dhe vajzave, janë komponentë të planifikimit hapësinorë me perspektivë gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore ka qenë pjesë e punëtorisë së parë, për Hartimin e Manualit për përfshirjen e perspektivës gjinore në planifikimin hapësinor, me ftesë të UNHABITAT.

25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas -16 Ditët e Aktivizmit

Sikurse në shumicën e vendeve të botës që organizohen aktivitete sensibilizuese/avokuese për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, edhe në Kosovës me rastin e shënimit të kësaj dite është hapur Fushata e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave, fushatë e cila fillon me 25 nëntor dhe vazhdon deri me 10 dhjetor, që është edhe Dita Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut.

Agjencia për Barazi Gjinore konform mandatit të saj, Ligjit për Barazi Gjinore si dhe kërkesave të dala nga politikat e miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që promovojnë dhe garantojnë barazinë gjinore në Kosovë, gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit ka organizuar aktivitete të ndryshme. Gjatë kësaj fushate ABGJ ka realizuar dy videoklipe, në të cilat adresohet domosdoshmëria e luftimit të dukurive negative, dhe

▪ *Sekuenca nga videoklipi "Qasja e grave në pronë dhe rëndësia e regjistrimit të pronës"*

nevoja që gratë të kenë qasje të barabartë në pronën dhe pasurinë familjare. Tema e videoklipit të parë është: "Qasja e grave në pronë - rëndësia e regjistrimit të pronës", dhe është realizuar në bashkëpunim me GIZ, kurse videoklipi me temë: "Forca fizike nuk e justifikon dhunën ndaj gruas" është realizuar në bashkëpunim me MKRS. Të dy videoklipet u transmetuan gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, në RTK.

Kurse, në kuadër të kampanjës sensibilizuese për eliminimin e dhunës ndaj gruas, UN Women si një nga partnerët ABGJ-së, ka organizuar disa aktivitete që promovojnë barazinë gjinore.

Kryeshefja ekzekutive e ABGJ-së, Edona Hajrullahu edhe gjatë një interviste ka vlerësuar rolin që ka luajtur UN Women në hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 "Gratë Paqja dhe Siguria".

"UN Women është një donator me të cilin kemi bashkëpunuar në hartimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 dhe gjithashtu përveçse ka luajtur rolin e donatorit ka qenë edhe shumë e angazhuar të jap kontribut në vetë hartimin e Planit të Veprimit, duke pasur parasysh eksperiencën e tyre apo edhe të zyrave të UN Women që janë në regjion", ka thënë ajo.

Hajrullahu ndër të tjera ka theksuar se në bazë të rezultateve dhe pritjeve të destinuara të Planit të Veprimit, gratë duhet të jenë të pranishme në numër më të madh në procesin e vendimmarrjes, ato duhet të jenë pjesë e hierarkisë së lartë të shërbimit diplomatik të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Një nga synimet e këtij plani të veprimit është edhe të siguroi trajtimin adekuat si dhe dëmshpërblim, që duhet t'ju sigurohet viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit, duke përfshirë këtu edhe njohjen e tyre ligjore.

Ndërkaq, ajo vlerëson se arsimimi dhe punësimi më i madh mund të përmirësojnë situatën e grave në Kosovë, rrjedhimisht mund të ndikojë edhe në parandalimin e dhunës gjinore.



Sekuenca nga videoklipi " Forca fizike nuk e justifikon dhunën ndaj gruas"

Sekuenca nga videoklipi " Forca fizike nuk e justifikon dhunën ndaj gruas"

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (Objektivi Strategjik 4 dhe 5), për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore si dhe mandatit të saj, Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë subvencionimin e pjesshëm të projekteve të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, dhe fuqizimin ekonomike të tyre.
Gjatë vitit 2013 Agjencia për Barazi Gjinore ka mbështetur personat fizik dhe personat juridik të cilët janë aktiv në fushën e barazisë gjinore.
Pra, gjithsej janë përzgjedhur katërmbëdhjetë projekte që i kanë plotësuar kushtet dhe specifikat e parapara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2012.
ABGJ ka mbështetur projektin "Serre për kultivimin e perimeve", ku si qëllim kishte mbjelljen e perimeve, përpunimin dhe konservimin e ushqimeve tradicionale. Si p.sh; Ajvari, pingjuri si dhe turshi të varieteteve të ndryshme. Po ashtu, është blerë aparatura e përgatitjes së këtyre produkteve, për përpunimin e tyre.

Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore

ABGJ ka bërë subvencionimin e projektit "Promovimi i punësimit dhe fuqizimi ekonomik i grave, përmes prodhimeve artizanale (dallamave, jelekëve, sa i përket veshjes së nusërisë) si dhe punëve të tjera". Më këtë rast janë punësuar disa gra që kanë punuar në qepjen e dallamave, jelekëve të nusërisë dhe artizanaleve të tjera me qëllim të shitjes së tyre dhe krijimit të mundësive për gratë nëna vetushqyese. Këto vlera krijuese mund të jenë burim i qëndrueshëm për gjenerim të të ardhurave për gratë dhe familjet e tyre.

Roli i mediave në pasqyrimin e roleve gjinore është tejet i rëndësishëm, më këtë rast ABGJ ka përkrahur projektin"Sensibilizimi për rolin e femrës përmes medias" nga Organizata për Hulumtime e Shërbime Sociale dhe Politike "KODI 21". Përmes kësaj organizate në rubrikën FEMRA, në portalin "Reporteri.net" dhe "Orainfo.com" gjatë vitit 2013 janë bërë përditësimet e lajmeve rreth trajtimit të temave, raporteve, intervistave që prekin çështjet gjinore, duke promovuar barazinë gjinore.

ABGJ ka përkrahur realizmin e projektit "Rritja e zhvillimit të biznesit të rrobaqepësisë", për personin Juridik-D.P.Z."FATI". Në kuadër të këtij projekti është ndihmuar në rinovimin dhe zgjerimin e lokalit si dhe blerjen e dy makinave qepëse.

ABGJ ka mbështetur projektin "Funksionalizimi i objektit në kuadër të aktiviteteve këshilluese për hortikulturë dhe ndërmarrësi" të Shoqatës së Grave "Parajsa Jonë", në Babush të Muhaxhirëve. Në kuadër te këtij projekti është ndihmuar në zgjerimin e hapësirës për kultivimin e perimeve dhe luleve.

▪ *Projekti "Serre për kultivimin e perimeve"*

▪ *Projekti: Promovimi i punësimit dhe fuqizimi ekonomik i grave, përmes prodhimeve artizanale (dallamave, jelekëve, sa i përket veshjes së nusërisë)*

ABGJ ka përkrahur projektin "Ngritja e një pemishte të manaferrave", të Pemëtarisë Doroci. Synimi i projektit ishte zgjerimi i hapësirës për mbjelljen e manaferrave, me qëllim të përpunimit të xhemit, reçelit, etj. Vlen të theksohet se themelueset e Shoqatës " Parajsa Jonë " dhe "Pemëtaria Doroci" janë zgjedhur feremeret e vitit 2013, nga MBPZHR.

ABGJ ka përkrahur projektin "Renovimi i stallës për bagëti të imta" të OJQ-së "Perimet" duke ndihmuar në blerjen e materialit për ndërtimin e stallës.

ABGJ ka bërë subvencionimin e pjesshëm për OJQ-në "Rikota". Ky projekt kishte si qëllim të rrisë zhvillimin e punëtorisë për përgatitjen e ëmbëlsirave. Në këtë rast është ndihmuar në blerjen dhe vendosjen e tezgës, për shitjen e produkteve, si dhe me pajisje për mbështjelljen dhe ruajtjen e ushqimit. Me projektin e saj ajo ka sjellë produkte shumë cilësore të gatuara nga mielli, si p,sh; lloje të ndryshme të ëmbëlsirave, kifleve, e gjërave tjera të ndryshme.

ABGJ ka përkrahur projektin "Punësimi i grave dhe pjesëmarrja në turizëm përmes trashëgimisë kulturore, në komunën e Dragashit të OJQ-së "Rona. Përmes këtij projekti femrave u është mundësuar që me punën e tyre të kontribuojnë në standardin e tyre jetësor. Projekti ka të bëjë me punët artizanale siç janë; punimi i mbulesave për tavolina, punime të vekut, qilima, punime të qëndisura, çorape,veshjet kombëtare etj.

Projekti: "Punësimi i grave dhe pjesëmarrja në turizëm përmes trashëgimisë kulturore, në komunën e Dragashit".

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes, për luftimin e barrierave kulturore dhe paragjykimeve të cilat kufizojnë femrën në viset rurale, ABGJ ka mbështetur projektin "Përkrahja e femrës në punësimin e viseve Rurale". ABGJ ka financuar blerjen e materialeve që përdoren për qëndisjen e punimeve artizanale tradicionale.

Duke parë nevojën e tregut për prodhimin cilësor të produkteve nga qumështi i dhisë ABGJ ka ndihmuar projektin "Përpunimi dhe paketimi i qumështit të dhisë dhe krijimi i vendeve të reja të punës" nga OJQ "Shqiponjat e Dardanisë". Përmes përpunimit të qumështit janë përgatitur lloje të ndryshme të djathërave dhe bylmet në përgjithësi. Projekti kishte si qëllim të zvogëlojë papunësinë tek femrat e viseve rurale, duke ofruar kushte më të mira socio-ekonomike.

▪ *Projekti: "Sensibilizimi për rolin e femrës përmes medias*

▪ *OJQ - "Rikota"*

▪ *Projekti: "Rritja e zhvillimit të biznesit të rrobaqepësisë"*

▪ *Projekti: "Material për punë dore për gratë e minatorëve"*

ABGJ ka përkrahur projektin "Material për punë dore për gratë e minatorëve" të OJQ- së Gratë e Minatorëve. Projekti në fjalë kishte si qëllim tu ofroj përkrahje dhe fuqizimin e grave të minatorëve për sigurimin e të ardhurave për këto kategori. Ndryshe, aktivitete e realizuara gjatë projektit ishin blerja e materialeve për thurje, thurja e veshjeve për fëmijë dhe të rritur dhe shitja e tyre.

▪ *Projekti: "Përkrahja e femrës në punësimin e viseve Rurale".*

▪ *Projekti: "Renovimi i stallës për bagëti të imta".*

▪ *Projekti: "Punësimi i grave dhe pjesëmarrja në turizëm përmes trashëgimisë kulturore, në komunën e Dragashit".*

Debati me temë - Edukimi i Drejtë për Barazi Gjinore tek Fëmijët.

Në kuadër të projektit "Skulp'edu" të subvencionuar nga Agjencia për Barazi Gjinore përveç trajnimeve të paraparë në projekt, ka organizuar edhe një tryezë diskutimi lidhur me rëndësinë e edukimit të fëmijëve mbi barazinë gjinore.

Ky projekt kishte si qëllim informimin mbi të drejtat e barabarta për adoleshentet si pjesë e vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve të të rinjve, për një zhvillim normal individual dhe institucional dhe për një përmbushje të suksesshme të detyrave. Në këtë tryezë ndër të tjera u tha se fëmijët që rriten në një mjedis ku ka dhunë në familje, mund të vuajnë nga një sërë çrregullimesh të sjelljes dhe emocioneve që ndikojnë në aftësitë e tyre për të mësuar dhe për t'u zhvilluar.

Prandaj, respektimi i barazisë pranohet si një standard minimal i kulturës së sotme morale dhe arsimore, ndërsa ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë është parakusht për sigurimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në jetën shoqërore.

▪ *Projekti: "Skulp'edu".*

Takimi i Grupit Punues Sektorial për Koordinimin e Donatorëve në Qeverisje, me fokus në Barazinë Gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimit Evropian, zhvilluan takimin e dytë të grupit punues sektorial për koordinimin e donatorëve në Qeverisje, me fokus të veçantë në barazinë gjinore.

Në këtë takim drejtuesit e ABGJ-së i kanë prezantuar planet dhe prioritetet për vitet në vijim në fushën e barazisë gjinore, kurse nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione i Kuvendit të Kosovës është folur për zbatimin në praktikë të ligjit përkatës për barazi gjinore.

Po ashtu, përfaqësuesit nga komuniteti i donatorëve, si Ambasada Suedeze dhe USAID-i u prezantuan raportet e tyre vlerësuese për studimin gjinor në Kosovë, si dhe përfaqësuesit nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe UNKT prezantuan aktivitetet e tyre të planifikuara në fushën e barazisë gjinore.

Ndërkaq, drejtuesit e Ministrisë së Integrimit Evropian vlerësuan se nevojitet që të ketë një koordinim sa më efikas të të gjithë akterëve, respektivisht duhet të ndodhë koordinim së pari i planeve dhe bashkërisht të vendosen mandej prioritetet në fushën e barazisë gjinore, në mënyrë që të ketë suksese më të mëdha.

Vizita në Institutin Evropian për Barazi Gjinore, Vilnius të Lituanisë

Përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore, Kryeshefja ekzekutive Edona Hajrullahu, kanë zhvilluar një vizitë zyrtare në Institutin Evropian për Barazi Gjinore, Vilnius Lituani.

Gjatë takimit është diskutuar për aplikimin e Indeksit të Barazisë Gjinore në procesin e hartimit të politikave publike dhe rreth mundësive të zhvillimit të indeksit gjinor për Kosovën, me ç'rast përfaqësuesit e Institutit Evropian për Barazi Gjinore shprehen gatishmërinë për bashkëpunim të mëtutjeshëm me Agjencinë për Barazi Gjinore në këtë aspekt.

Po ashtu, gjatë kësaj vizite, përfaqësuesit e ABGJ-së kanë marrë pjesë edhe në Forumin e Eksperteve si dhe në Konferencën ku është bërë edhe lansimi i "Qendrës për Resurse dhe Dokumentim", në të cilën do të paraqiten të gjitha dokumentet si dhe aktivitetet për barazinë gjinore nga të gjitha vendet evropiane.

Vizita në Institutin Evropian për Barazi Gjinore, Vilnius të Lituanisë

Pjesëmarrje në konferencën "Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Prostitucioni", Kroaci

Kryeshefja ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edona Hajrullahu mori pjesë në konferencën me temë: "Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Prostitucioni", të mbajtur në Zagreb të Kroacisë.

Organizimi i kësaj konference kishte për qëllim forcimin e platformave kombëtare dhe tranzicionale për bashkëpunim dhe koordinim, për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin seksual të tyre.

Në fjalën e saj gjatë konferencës, Hajrullahu ka theksuar se grupet sociale të rrezikuara nga trafikimi me qenie njerëzore janë fëmijët, por edhe të rriturit.

"Viktimat fëmijë e të rritur detyrohen të migrojnë si rezultat i nivelit të lartë të varfërisë në vendet e origjinës duke u joshur nga premtimet për një jetë më të mirë dhe punë të ligjshme. Edhe pse, shumica e viktimave të identifikuara së fundmi në Kosovë janë trafikuar brenda vendit, shumica e tyre janë për qëllime të shfrytëzimit seksual, ndër to edhe një numër i tyre kanë qenë vajza të mitura".

Në prezantimin e saj, Hajrullahu shtoi se koordinimi i luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore ka për synim ndërtimin e një shoqëri që jeton në paqe, e pa kërcënuar nga trafikimi dhe krimi i organizuar, duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e Kosovës, si një vend i qetë e me standarde të larta të sigurisë.

Pjesëmarrje në konferencën "Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Prostitucioni", Kroaci

Pjesëmarrja në Konferencën -Konventa e tretë e Stambollit -Mbi Promovimin e të Drejtave të Grave

Pjesëmarrja në Konferencën Konventa e tretë e Stambollit Mbi Promovimin e të Drejtave të Grave

Me ftesë të Drejtorisë së Përgjithshme për Statusin e Grave që është nën Ministrinë e Familjes dhe Politikave Sociale të Republikës së Turqisë, përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore të dhe kryeshefja ekzekutive, Edona Hajrullahu qëndruan në vizitë për dy ditë në Stamboll të Turqisë.

Gjatë ditës së parë përfaqësuesit nga Kosova e zhvilluan një takim pune, ku u diskutua rreth bashkëpunimit dhe shkëmbim të informacionit me: Institutin Evropian për Barazi Gjinore, Ministrinë e Familjes dhe Politikave Sociale të Republikës së Turqisë, përfaqësuese nga Mali i Zi dhe Maqedonia.

Takimi kishte për qëllim:

- *Të informohet mbi Institutin Evropian për Barazi Gjinore, aktiviteteve të projektit të IPA-s, të arriturat dhe statusin.*
- *Të vazhdojë ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e përmirësimit të politikave për barazinë gjinore dhe për të mbajtur këtë si një ndër prioritetet e administratave të tyre kombëtare.*
- *U diskutuan zhvillimet e fundit rreth strategjive të tjera dhe programeve në mënyrë që të sigurohet një perspektivë gjinore, dhe se barazia gjinore është një nga temat kryesore që duhet dhënë përparësi procesit të zgjerimit.*
- *U identifikuan fushat e përbashkëta të interesit dhe u planifikuan aktivitete të përbashkëta për projektin e ardhshëm të IPA-së, në vitin 2014.*

Ndërsa, gjatë ditës së dytë, delegacioni i ABGJ-së mori pjesë në punimet e Konferencës Ndërkombëtare (në vitin e tretë) të Konventës së Stambollit - Mbi Promovimin e të Drejtave të Grave.

Numri i shteteve të cilat e kanë nënshkruar Konventën në shtator të vitit 2013 janë pesë, Turqia, Portugalia, Mali i Zi, Republika e Shqipërisë dhe Italia. Konventa duhet të ratifikohet së paku edhe nga pesë shtete të tjera në mënyrë që të hyj në fuqi.

Aktivitetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me rastin e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, ka monitoruar shtypin e përditshëm, me fokus hapësira që i është kushtuar grave në mediat e shkruara. Kryesisht mediat janë fokusuar në shkrimet që kanë të bëjnë më dhunën në familje, pasi 16 Ditët e Aktivizmit njihen si fushatë sensibilizuese për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas.

Gjatë monitorimit të shtypit është vërejtur një ndryshim pozitiv, rreth përfaqësimit të gruas në media, ku hapësirë të konsiderueshme i është kushtuar edhe fushatës zgjedhore dhe prezantimit të kandidatëve femra.

Sa i përket rezultateve zgjedhore fitorja e Mimoza Kusari-Lilës është përmendur në shumë gazeta si shembull pozitiv, femra e parë kryetare e një komune në Kosovën e pasluftës, duke shënuar histori në vendin tonë. Gazetat të cilat janë monitoruar janë: "Koha ditore", "Kosova Sot" dhe "Zëri".

Statistikat e përfaqësimit në MKRS : Numri i përgjithshëm i të punësuarve në MKRS është 578. Prej tyre 332 janë meshkuj ose 57,44%, kurse femra 246 ose 42,56 %. Në pozita udhëheqëse në MKRS janë të angazhuar 51 të punësuar, prej të cilëve 39 (76.47 %) meshkuj, kurse 12 (23.53%) femra.

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MKRS*

MKRS ka mbështetur sportistet femra

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka përkrahur dhe mbështetur zhvillimin e sportit në Kosovë, më konkretisht ka avancuar fermat sportiste.

Ky aktivitet është ndërmarr në mënyrë që të përmirësohen kushtet, për gara sa më cilësore dhe për prezantim sa më të mirë të sportistëve tanë, në arenën ndërkombëtare. Pra, është një hap tejet domethënës qe MKRS, ka bërë në përkrahje të sportistëve kulminant, dhe në avancimin e tyre për garat ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e Federatës së Xhudos së Kosovës, në Kampionatin Botëror të Xhudos për senior që u mbajt në Rio De Janeiro, ku morën pjesë Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova, ishte pa dyshim kulminacioni i sportisteve tona apo të themi edhe i gjithë vitit për Federatën e Xhudos.

Sportistja Majlinda Kelmendi, u kurorëzua me medaljen e Artë, ndërsa Nora Gjakova u radhit e shtata në ranglistën botërore, ku për herë të parë nën Flamurin e Kosovës, garuesja Majlinda Kelmendi i sjellë Medaljen e Artë Kosovës.

Prandaj, duke qenë të bindur se potenciali dhe fuqia e vërtetë e sportit të Kosovës qëndron tek të rinjtë, Ministria ka vazhduar të avancoj politikën programore në mbështetje të federatave të sportit për zhvillimin dhe avancimin e kualiteteve të sportistëve të rinj dhe të talentuar, për të siguruar më shumë mundësi për trajnime profesionale dhe për të përmirësua nivelin e sportit në Kosovë.

Pjesëmarrja e Federatës së Boksit të Kosovës, në Kampionatin Evropian për Femra, EUBC në Keszthely të Hungarisë me boksierët femra, ku Albulena Gubetini u stolis me Medaljen e Bronztë.

Federata e Boksit për herë të parë është paraqitur zyrtarisht në garat Evropiane me garuese femra, ku edhe rezultatet kanë qenë inkurajuese për të vazhduar me punët të mëtejme.

Departamenti i Sportit ka prioritet sportin femërorë duke mbështetur të gjitha Federatat e Sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive, ku vlera financiare është mbi 200.000,00 euro si në Shpërblimin e Sportisteve të cilat kanë arritur rezultate kulmore në garat ndërkombëtare, grumbullimi i kampeve verore të grup moshave të reja të Federatës së Futbolli, Basketbollit, Hendbollit,Volejbollit, Boksit, Xhudos, Notit, Skijimit, Atletikës etj.

▪ *Majlinda Kelmendi Kategoria 52,kg,Medalje e Artë në Kampionatin Botërorë në Rio De Janeiro*

Temat e shtjelluara ishin:

- *Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat në vendet e tyre të punës, në kontekst të standardeve ndërkombëtare dhe mekanizmave implementues të tyre.*
- *Kuadri ligjor dhe mekanizmat vendor për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat në sferën e punësimit në administratën publike.*
- *Instrumentet e veçanta ligjore dhe Dokumentet strategjike lidhur me promovimin e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës.*
- *Rastet e sjelljes dhe praktikat më të mira të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat në vendet e tyre të punës.*

▪ *Kampionati Evropian për femra në Hungari, Albulena Gubetini me Medalje të Bronztë.*

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik Në vazhdimësi ka vizituar bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat udhëhiqen nga gratë. Qëllimi i këtyre vizitave ishte të njoftohet për të arriturat, sfidat apo vështirësitë që ballafaqohen ato. Ajo ka bërë përpjekje për mundësitë apo lehtësimin e tyre lidhur me obligimet që kanë ndaj shtetit, siç është fjala për taksa - pagimet e tyre në kuadër të bizneseve, për të pasur mundësi që plasimin në treg ta kenë më të garantuar.

Sa i përket vetëdijesimit të femrave lidhur me shëndetin e tyre, ZBGJ në këtë ministri ka dërguar një kërkesë në QKUK për (Eho/Mamografi, Papa-test dhe Strisho), ku në janar të 2014 do të fillojnë këto kontrolle.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Infrastrukturës, gjatë kampanjës së 25 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare për Eliminim e Dhunës ndaj Gruas, ka organizuar një seminar me punonjëset e MI-së. Tema e seminarit ishte: "Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat në vendet e tyre të punës". Seminarin e ndoqën 35 zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës. ZBGJ në Ministrinë e Infrastrukturës ka raportuar rreth statistikave të të punësuarve në vitin 2013 në këtë ministri.

Gjithsej të punësuar janë 266, nga të cilët 200 ose 75,18% janë meshkuj, kurse 66 ose 24,81% janë femra. Në MI 7 femra kanë pozita vendimmarrëse.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nisur nga Plani i Veprimit për Fuqizim Ekonomik, Objektivi Strategjik 1, (Veprimi 1.3 Të krijohen mekanizma për edukimin dhe vetëdijesimin e të rinjve mbi dhunën në familje), ka filluar kampanjën e 16 Ditëve të Aktivizmit me debate, ligjërata me nxënës, ka shpërndarë materiale, broshura, fletëpalosje e dokumente tjera, të cilat kanë të bëjnë me dhunën në familje, trashëgiminë, linjat ndihmëse, si dhe ka shpërndarë dokumentin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, të hartuar nga ABGJ. Këto ligjërata u mbajtën me nxënësit në Komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, si dhe të Deçanit. Gjatë fushatës MASHT ka vizituar edhe strehimoren "Shpresa" dhe "Shtëpitë e Fëmijëve - SDSF " në Prishtinë.

Ndërsa, në shënimin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ka organizuar një debat me temë: "Dhuna në shkolla dhe dhuna në baza gjinore, brenda institucionit".

Me 25 prill në Ditën e Vajzës, ka realizuar një vizitë në kompaninë e prodhimeve të qumështit (VITA) dhe të lëngjeve (TANGO), në komunën e Istogut, duke qenë se kjo ditë simbolike synon tejkalimin e paragjykimeve, stereotipeve dhe stigmatizimeve mbi profesionet që mund t`i ushtrojnë vajzat njësoj si djemtë. ZBGJ me këtë vizitë promovoi mundësinë e përfshirjes së vajzave në teknologjinë e prodhimit të ushqimeve dhe perspektivën e tyre për të udhëhequr dhe punuar në biznese të ndryshme.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ka mbajtur takim me noter më qëllim të avancimit të së drejtës së gruas në pronë, më konkretisht qëllimi i këtyre takimeve ka qenë që në aktin e noterisë të futet si rekomandim për palët neni 16 i Ligjit për Barazi Gjinore, i cili specifikon se pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë duhet të regjistrohet në regjistrat publik në emër të dy bashkëshortëve. Gjithashtu ka mbajtur punëtori me stafin AKK-së, me temë:" Legjislacioni në fuqi, lidhur me të drejtat pronësore dhe me barazinë gjinore në Kosovë".

Aktivitetetet e Zyrtareve për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna

Më qëllim të ngritjes së shkallës së bashkëpunimit mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, ZBGJ ka organizuar takim mes dy agjencive, ku AKK është zotuar të ndihmojë ABGJ-në, në fushata ndërgjegjësimi dhe në aktivitete tjera që do të avanconin shfrytëzimin e të drejtave ligjore të grave, mbi pronën e paluajtshme në Kosovë.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë- "Femra më e suksesshme afariste ". Plani i Veprimit për Fuqizim Ekonomik, (Veprimi. 1 Ngritja e Ndërmarrësisë në mesin e Grave). ZBGJ raporton për aktivitetin e ndërmarrë nga kjo ministri, me rastin e shënimit të muajt të gruas. Me qëllim të promovimit dhe ngritjes të ndërmarrësisë së femrave në Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Dhomën Ekonomike të Grave G7, në kuadër të projektit "Ditët e Biznesit të Vogël 2013" ka organizuar ceremoni me rastin e ndarjes së çmimeve për 5 femrat më të suksesshme në ndërmarrësi. Çmimi i pare u nda në vlerë 1000 EUR, derisa katër çmimet tjera me nga 500 EUR.

Në vazhdën e "Ditëve të Biznesit të vogël 2013" MTI në bashkëpunim me Qendrën Juglindore për mësim në ndërmarrësi, për të dytën herë radhazi ka organizuar Konferencën dhe Panairin "Gratë në Lidership dhe Ndërmarrësi"që kishte si qëllim fuqizimin e potencialit për ndërmarrësi tek gratë në Kosovë.MTI gjegjësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve gjatë 2012, 2013 ka bërë hapjen e zyrave nëpër komuna për regjistrim të bizneseve që është një lehtësim i dukshëm.

E arritur ne ARBK prej vitit 2012 është ri-dizajnimi i formularit të regjistrimit të bizneseve që identifikon pronarin duke shënuar gjininë dhe lehtëson procedurën e përcjelljes së statistikave – të ndara në baza gjinore. Numri i bizneseve në pronësi të grave janë gjithsejtë 11%.

Aktualisht MTI ka 188 të punësuar. Të gjinisë femërore janë 71 ose 38% nëpunëse, ndërsa të gjinisë mashkullore janë gjithsej 117 nëpunës, që përbejnë 62% .Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të përqindjes prej 3% të numrit të femrave, ndërsa krahasuar me katër vite më herët përqindja e femrave ka ndryshuar nga 30 % në 2010, 35% në 2011, pastaj 36% ne 2012 dhe 38 % në 2013

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, në bazë të objektivave të parapara në PKBGJ ka organizuar trajnim në bashkëpunim me OSBE në regjionin e Gjilanit lidhur me temën: "Të drejtat e Grave me Aftësi të Kufizuara dhe Grave nga Zonat Rurale". Ky trajnim kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht në fushën e barazisë gjinore.

▪ *"Zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat në vendet e tyre të punës".*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MASHT*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga MTI*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MSH*

Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve në fushën e barazisë gjinore për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Barazinë Gjinore Nr. 2004/2, e që prekin të drejtat e personave sidomos grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga viset rurale.

Po ashtu janë realizuar projekte gjatë Fushatës Kundër - Trafikim, lidhur me vetëdijesimin e nxënëseve të shkollave fillore dhe ato të mesme lidhur me rreziqet e trafikimit. Aktivitetet u zhvilluan me prezantimin e materialit për trajnim, prezantimi i video-dokumentarit që lidhet me rreziqet dhe pasojat e trafikimit, shpërndarja e fletëpalosjeve dhe vendosja e posterëve me moton "Hapi sytë, Ke kujdes". Aktivitetet janë zhvilluar në komunën e Mitrovicës, Gjilanit, Lipjanit, Junikut, Dragashit dhe Prizrenit.

ZBGJ se kanë përkrahur projektin me temë "Autobusi i tolerancës" te shoqatës së grave të verbra në shumë prej 1000 euro.

Zyrtarja për barazi gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë, konform aktiviteteve të parapara në PKBGJ, Objektivi Strategjik. 3 (Veprimi 3.1 Të ndërtojmë dhe të fuqizojmë kapacitetet e punonjëseve të shëndetësisë të shërbimeve sociale, për ofrimin e shërbimeve, viktimave të dhunës në familje), në bashkëpunim me OSBE, ka organizuar trajnime për 170 punëtorët shëndetësor, rreth përkujdesjes së ofruar për rastet e dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore. Trajnimet u mbajtën në regjionin e Gjakovës, Pejës, Prizrenit, Mitrovicës dhe në Prishtinë. Ndërsa, në bashkëpunim me UNDP ka organizuar edhe 6 trajnime te tjera në disa regjione, ku morën pjesë gjithsej 180 punonjës të shëndetësisë. MSH në bashkëpunim me MPMS ka draftuar Udhëzimin Administrativ nr.12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje.

MSH ka hartuar edhe Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje të cilëve iu është shqiptuar masa për trajtim nga varësia e alkoolit dhe substancave pskiotrope. MSH në bazë të Strategjisë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në bashkëpunim me UNFPA-në ka hartuar Udhërrëfyesin për dhunën e bazuar në gjini, është përfunduar drafti dhe është nënshkruar nga Ministri i Shëndetësisë Prof.dr. Ferid Agani. Po ashtu, MSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Kosovare për Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MSH Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës në Kosovë, si dhe me Koalicionin e Strehimoreve të Kosovës, për shërbime shëndetësore falas dhe furnizim me barëra të listës esenciale.

ZBGJ ka qenë bashkorganizatore e fushatës për vetëdijesim e luftës kundër kancerit të gjirit, po ashtu MSH bazuar në Objektivin strategjik 3 të PKBGJ (Përmirësimi i shëndetit të vajzave dhe grave) i është bashkëngjitur fushatës së Java Evropiane e testimit për HIV/AIDS, 22 – 29 Nëntor me moton " Fol për HIV, testohu për HIV". Po ashtu janë shpërndarë 25.000 fletëpalosje me informatat për parandalimin e HIV.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, ka iniciuar organizimin e vizitave mjekësore në QKUK-(mamografi) për zyrtaret e Qendrës së Studentëve. Kjo vizitë është përkrahur nga udhëheqja e Qendrës së Studentëve dhe stafi i QKUK-së.

Gjithashtu, ZBGJ ka mbajtur edhe debat lidhur më të drejtat e grave dhe vajzave konform Ligjit për Barazi Gjinore.

Përfaqësimi gjinor në Qendrën e Studentëve, për vitin 2013.

Nr.total i të punësuarve	Meshkuj	Femra	Përqindja e femrave
232	164	68	25%

Femra në pozita udhëheqëse në Qendrën e Studentëve

Nr.total i punëtoreve në vende udhëheqëse	Meshkuj në udhëheqje	Femra në udhëheqje
7	5	2- 28.5%

Numri i studenteve në Qendrën e Studentëve

Nr. total i studentëve	Meshkuj	Femra	Përqindja
3448	1037	2141	62%

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka raportuar mbi gjendjen aktuale të të punësuarve në MMPH.

Totali i të punësuarve në MMPH	Meshkuj	Femra
208	126	82
Përqindja	60.57%	39.43%
Pozita udhëheqëse	42	18
Përqindja	70.00%	30.00%

Ndryshe, MMPH në shenjë Nderimi për Kontributin e Gruas gjatë periudhës së luftës 1998-1999, ka marr iniciativën në ndërtimin e një Memoriali kombëtar për të nderuar qindra mijëra gra që shërbyen dhe dhanë një kontribut të rëndësishëm për çlirimin e Kosovës. Memoriali për nderimin e kontributit të gruas do të vendoset në Parkun e ri të qytetit, përballë Pallatit të Rinisë.

Zyrtarja për Barazi Gjinore, Mundësi të Barabarta në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ka raportuar mbi të dhënat në lidhje me rastet e dhunës në familje, të cilat kanë kërkuar ndihmë në këtë qendër.

Gjatë mbledhjes së raportit ka hasur në numër të konsiderueshëm të femrave që kanë kërkuar ndihmë dhe shumica e tyre janë evidentuar si maskime të rastit, dhe besohet që pasojat kanë qenë rezultat i dhunës në familje. Nga këto raste të evidentuara ka pasur raste kur pacienti nuk ka mundur t'i shpëtojë vdekjes. Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura në QKUK, dhuna në familje vazhdon të jetë tejet prezentë edhe në Kosovë.

Raporti për numrin e shënuar dhe të evidentuar, marr nga QKUK nga muaj Janar-Dhjetor 2013,

Nr.	MUAJT	Intoksikime	Rrahje	Armë të zjarrta	Armë të ftohta
1	JANAR	21	19	11	1
2	SHKURT	13	20	13	1
3	MARS	5	12	4	1
4	PRILL	9	32	11	0
5	MAJ	15	14	12	0
6	QERSHOR	13	35	5	1
7	KORRIK	11	16	0	0
8	GUSHT	3	16	2	0
9	SHTATOR	3	16	1	0
10	TETOR	7	13	1	1
11	NËNTOR	12	14	8	0
12	DHJETOR	11	14	4	0

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural raporton mbi aktivitetet e ndërmarra nga kjo ministri të bazuara në Planin e veprimit per fuqizim ekonomik, Objektivi Strategjik 2, (Veprimi 2.3.7 – MBPZHR- Përkrahja e grupeve të grave, kooperativave të përfshira në biznes të bujqësisë dhe blegtorisë- Përmirësimi dhe rritja e prodhimit dhe përmirësimi i qasjes në treg).

MBPZHR ka organizuar konferencën: " Dita e Gruas Fermere" si dhe ka ndarë subvencione për gratë feremere, gjatë vitit 2012. Roli i gruas fermer ka qenë dhe vazhdon të jetë, rol i rëndësishëm në zhvillimin e këtij sektori në vendin tonë, ku një numër i madh i grave fermere janë duke kontribuar në zhvillimin dhe avancimin e veprimtarive bujqësore, të cilat me punën e tyre, kanë arritur që tashme të jenë udhëheqëse të shumë agrobizneseve në Kosovë.

Duke parë angazhimin e madh të grave në bujqësi dhe kontributin e tyre për zhvillimin e këtij sektori, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, krahas përkrahjes financiare, këtë vit për herë të dytë në bashkëfinancim me NOA/USAD-in ka organizuar manifestimin "Dita e gruas fermerë", që në mënyrë simbolike shënon ditën e të gjitha grave, të cilat merren me aktivitete bujqësore. Në kuadër të këtij manifestimi, janë ndarë edhe grante investive për gratë fermere, të cilat gjatë viteve të fundit me punën e tyre në sektorin e bujqësisë, kanë dhënë rezultate pozitive si në shtimin e prodhimtarisë ashtu edhe në punësimin e shumë grave tjera në veprimtaritë e tyre bujqësore.

Çmimi për "Gruan fermere të vitit 2013" në bazë të kritereve të përcaktuara nga Komisioni i përbërë nga: zyrtarë të MBPZHR-së, përfaqësues të NOA/USAID-it, përfaqësues nga sponsorizuesit KEP, përfaqësues te OJQ-ve, IADK-së (njëherë edhe udhëheqës të Unionit të OJQ-ve fermere), kanë bërë zgjedhjen e dy fermereve me te suksesshme të viti 2013, te cilat u shpërblyen me nga 3 mijë euro nga KEP Trust (Instituti mikrofinanciar). Përfituese ishin:

-***Sylbije Sahiti nga komuna e Lipjanit***, e cila merret me kultivimin e pemëve dhe perimeve.

-***Xhevrije Doroci nga komuna e Mitrovicës***, e cila merret me prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore.

▪ *Aktivitet i realizuat nga MBPZHR*

Konferenca kishte për qëllim:

- *Pranimin e rëndësisë se rolit të grave fermere në rritjen e zhvillimit bujqësor dhe rural,*
- *Promovimi i imazhit pozitiv të grave fermere të Kosovës si dhe inkurajimi i investimeve në këtë sektor vital për të ardhmen e zhvillimit ekonomik të vendit,*
- *Ngritja e vetëdijes për prodhimet vendore, përmirësimi i imazhit të fermerëve të Kosovës tek publiku vendor dhe si rrjedhojë rritja e shitjes dhe konsumit të të njëjtave.*

MBPZHR- Grantet/subvencionet e shpërndara gjatë vitit 2012. Kjo ministri me qëllim të promovimit të punës së grave feremere dhe inkurajimit të tyre për të marrë me prodhimtari ka ndarë gjatë vitit 2012 grante për përfitueset femra në fushën e kultivimit dhe mbajtjes së : dhive, deleve, lopëve, bletëve, dhe grave që merren me bujqësi kultivimin e grurit;

- *Për mbajtjen e dhive kanë ndarë për tre përfituese, në total 620.00 €*
- *Për mbajtjen e deleve, për 8 gra përfituese, MBPZHR kanë ndarë në total 6,910.00 €*
- *Për mbajtjen e lopëve qumështore, për 23 gra fermere përfituese, janë ndarë 12,200.00 €*
- *Për kultivimin e grurit,për 49 gra përfituese, janë ndarë në total 19.706.00 €*
- *Për kultivimin e bletëve, për 11 gra përfituese, janë ndarë 4,130.00 €*
- *Përfituesit ishin nga Komuna të ndryshme, si dhe gratë përfaqësuese të minoriteteve.*

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim ka raportuar se kjo ministri ka përkrahur ndërtimin e 72 shtëpive për komunitete, ku prej tyre 15 gra kryefamiljare, kanë qenë përfituese të kësaj iniciative. Në kuadër të kampanjës kundër kancerit të gjirit ZBGJ në Ministrinë e Komunitetit dhe Kthimit ka realizuar vizitë mjekësore për femrat punonjëse në këtë ministri, për parandalimin dhe zbulimin e hershem të sëmundjes së kancerit të gjirit, me moton "Të njohësh trupin tënd" .

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjilanit, ka organizuar konferencë për media rreth "Fuqizimit të pozitës së gruas në shoqërinë tonë". Njëkohësisht, ka mbajtur disa takime me mekanizmin koordinues Kundër Dhunës në Familje, me përfaqësuesit nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, si dhe një debat me qëllim të ngritjes së njohurive dhe vetëdijesimit të popullatës në lidhje me të drejtën pronësore dhe në trashëgimi, pa diskriminim gjinor.

Ndërsa, në shënimin e 25 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas, ka realizuar një broshurë dhe pano me moton: "Dhuna në familje dhe Trashëgimia Pronësore".

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë, ka vizituar komunitetin Rom, Ashkali, Serb dhe komunitetin Qerkez. Qëllimi i vizitave ishte integrimi i këtyre komuniteteve në shoqëri. Gjithashtu, ka organizuar trajnim me nxënësit e Shkollës së Mesme të Ulët në Vushtrri, me temë:"Të drejta e fëmijëve dhe obligimet ndaj tyre", të financuar nga Kryetari i Komunës.

Ndërkaq, me 1 Qershor- Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, ka organizuar një shëtitje me fëmijë me aftësi të kufizuar, ndërsa me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Sidës ka mbajtur ligjëratë me nxënësit e SHMU në komunën e Vushtrrisë. Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ- Vushtrri

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit, gjatë vitit 2013 është fokusuar kryesisht në realizimin e objektivave të dala nga Plani i Veprimit për Barazi Gjinore të Komunës së Prizrenit, për periudhën 2012-2014.

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ në MI*

Komuna e Prizrenit në vazhdimësi ka ofruar dhe ofron përkrahje logjistike sa i përket ofrimit të objekteve, në shfrytëzim të OJQ-ve komunale, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Më këtë rast ka mbështetur me lokal në Qendrën për Zhvillim dhe Kulturë "Europa", OJQ-në e grave "Femra për femra me aftësi të kufizuar", ku punohen, ekspozohen dhe shiten punimet e rreth 50 personave me aftësi të kufizuar. Ndërkaq, me rastin e kampanjës sensibilizuese të 16 Ditëve të Aktivizmit, ZBGJ ka organizuar tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të institucioneve relevante për parandalimin e dhunës ndaj grave, si; Gjykata, Policia, Drejtori komunale, Prokuroria, OJQ etj.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Obiliqit, fushatën e 16 Ditëve të Aktivizimit e ka hapur me shpërndarjen e kordeles së bardhë, që është simbol i kësaj dite, vendosjen e posterit dhe shpërndarjen e fletëpalosjes për parandalimin e dhunës në familje. Në vazhdën e kësaj fushate është organizuar debat me temën: "Nëse e respektoni gruan keni siguruar të ardhmen".

Ndërsa, për 8 Mars - Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ka mbajtur një tryezë të rrumbullaket me temë: "Femra dhe Rëndësia e Saj". ZBGJ në këtë komunë ka mbajtur takim me gratë e lagjes së Romëve në Plemetin për përfshirjen e të gjitha femrave në organizimin e mësimit jo formal (Zhdukja e analfabetizmit tek gratë e këtij komuniteti).

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit, gjatë vitit 2013 ka qenë e përqendruar në rastet e diskriminimit në baza gjinore, dhe ka qenë mjaft e angazhuar në ndikimin e politikave dhe proceseve që e promovojnë barazinë gjinore, parandalimin dhe mbikëqyrjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut, në bazë të gjinisë.

ZBGJ në shënim të 25 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, ka mbajtur tryezë rreth dhunës në familje, me këtë rast është bërë vendosja e kordeles së bardhë tek gratë dhe burrat, janë shpërndarë postera, si dhe fletushka. Të ftuar në tryezë ishin, Njësiti për dhunë në familje nga Policia e Drenasit, Gjykata Komunale, QPS, QSVDHF si dhe OJQ-të e Drenasit.

Sa i përket të punësuarve në institucionet publike në këtë komunë janë si vijon: një femër është drejtore, pra pozitë udhëheqëse në komunë, pozita drejtuese në arsim janë gjithsej 36, prej tyre 3 femra dhe 33 meshkuj, poste menaxhuese në shëndetësi janë gjithsejtë 14, ku 7 janë femra dhe 7 meshkuj. Kurse, të shërbyesit civil nga 28 shefa 8 janë femra dhe 20 meshkuj. Gjithsejtë të punësuar në institucione publike janë 1337 veta, prej tyre 481 femra dhe 856 meshkuj. Sa i përket rasteve të dhunës në familje të marra nga QPS, gjatë vitit 2013 janë paraqitur 6 raste të femrave që kanë përjetuar dhunë.

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Kaçanikut, gjatë 2013 ka mbajtur disa ligjërata nëpër vise rurale dhe urbane, ku si temë kishin: Barazia gjinore dhe legjislacioni ynë, Fuqizimi i gruas në vendimmarrje, Buxhetimi i ndjeshëm gjinor - Pjesëmarrja e grave në hartim dhe planifikim të

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ- Gjilan*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ- Vushtrri*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ- Prizren*

buxhetit, si dhe mbi Trashëgiminë dhe të drejtën e grave, në trashëgimi. ZBGJ gjatë një tryeze të mbajtur nga Këshilli Lokal i Veprimit (ombrellë e të gjitha OJQ-ve që veprojnë në Kaçanik) ka realizuar një prezantim mbi rolin dhe rëndësinë e grave në hartimin dhe planifikimin e buxhetit.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Mitrovicës, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ka mbajtur tryezë diskutimi me temë: "Sfidat që hasin gratë në shoqërinë tonë", prezentë në këtë takim ishin Komuniteti për Barazi Gjinore, Shoqata Hendikos, Zëri i Prindërve, përfaqësues të Shoqatës së Sindromit Down, Shoqata e prindërve të Dëshmorëve. Ndërsa, së bashku me Komitetin për Barazi Gjinore ka organizuar vizitë shkollave të mesme të Mitrovicës, për të parë nga afër gjendjen

e femrës në institucionet arsimore. Gjithashtu, ka organizuar kontrolle gjinekologjike për gratë e komunitetit RAE.

Krahasuar me vitet e kaluara në komunën e Mitrovicës, gjatë 2013 kanë filluar të lëvizin gjërat në aspektin pozitiv, duke filluar me ndarjen e buxhetit në vlerë prej: 5.000 Euro për aktivitetet e Zyrtares për Barazi Gjinore dhe 15.000 Euro për Grupin e Grave Asambleiste.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Dragashit, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ka mbajtur takim me femrat e administratës së Komunës së Dragashit, si dhe me familjare të dëshmorëve, dhe ka realizuar një vizitë tek femrat e fabrikës–tjerrtores "Ramatekese", në Dragash. Vizita ka vazhduar edhe tek një grup i femrave me aftësi të kufizuar të dy komuniteteve me një debat.

Me Grupin jo formal të Grave ka mbajtur disa takime gjatë vitit, lidhur me problemet e grave në komunën e Dragashit, po ashtu ka mbajtur trajnime të ndryshme vetëdijësuese për ngritjen e kapacitet të këtij grupi.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës, më qëllim të fuqizimit dhe avancimit të gruas, me rastin e shënimit të 8 Marsit, ka ndarë disa çmime laureat për gratë më të suksesshme në fushën e Shëndetësisë, Arsimit, Mirëqenie Sociale, ne Biznes dhe Ekonomi, Kulturë dhe Media. ZBGJ në bashkëpunim me Grupin e Grave në komunën e Pejës, ka mbajtur edhe tryezë me temë: "Gruaja në Politikë dhe vendimmarrje" lidhur me vetëdijesimin e gruas në përfshirjen politike.

Ndërkaq, gjatë kampanjës së 16 Ditëve të Aktivizmit ka realizuar një sërë aktivitetesh për parandalimin e dhunës ndaj gruas, me akteret relevantë që kanë influencë në parandalimin e kësaj dukurie.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Skenderajt, në bashkëpunim me OSBE-në kanë formuar Grupin jo formal të grave, ku me këtë rast kanë zhvilluar disa takime dhe janë shqyrtuar problemet më të cilat ballafaqohen gratë, si dhe janë shqyrtuar mundësitë e zgjidhjes së këtyre problemeve. Ndërkaq, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas ka mbajtur një tubim solemn, ku kanë qenë prezent 400 gra. ZBGJ në komunën e Skenderajit ka organizuar një takim në fshatin Runik të kësaj komune mbi Rolin dhe pozitën e femrës në zonat rurale.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Rahovecit, me rastin e 8 Marsit ka organizuar debat me temë: "Gratë në procesin e vendimmarrjes". Në këtë takim ishte prezent edhe Kryetari i komunës Smajl Latifi, ku theksoi se nuk mund të jemi të kënaqur me përfaqësimin e gruas në jetën institucionale e publike. Ndërkaq, sipas ZBGJ-së nevojitet të rritet numri i grave dhe vajzave në administratën komunale, ngase numri më i madh i tyre punojnë në shërbime teknike dhe të mirëmbajtjes. Në ekzekutivin e Komunës janë të angazhuara vetëm dy femra si udhëheqëse të drejtorive.

Me këtë rast nxënësit e shkollës së mesme "Xhelal Hajda-Toni" të Drejtimit Juridik, të klasave 9, 10 dhe 11, shpalosën shqetësimet në lidhje me pozitën dhe rolin e gruas në shoqëri, përmes eseve me temat si: Dhuna në familje; Punësimi i femrës dhe Femrat në pozita udhëheqëse.

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ-Drenas*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ-Drenas*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ- Dragash*

▪ *Aktiviteti i realizuar nga ZBGJ- Rahovec*



info@abgj-ks.net